



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
DREJTORIA E SPITALIT PSIKIATRIK**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**Lënda:** PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot më datë 11.10.2024, në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhrër të titullarit të autoritetit kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme :

**Objekti Prokurimit:** “F.V pajisje teknologjike për pavionin e të sëmurëve kronik burra”

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP) :** 39300000-5

**Vlera e fondit limit: 12,842,833** (Dymbëdhjet milion e teteqind e dyzet e dy mije e teteqind e tridhjet e tre ) **lekë pa TVSH.**

**Referenca** REF- 24213-10-11-2024

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Spitali Psikiatrik ”Ali Mihali” Vlore, (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

**• KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë :**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë :**

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) :**

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021 , 2022 dhe 2023 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet, konkretisht jo më e vogël 12,842,833 (Dymbëdhjet miljon e teteqind e dyzet e dy mije e teteqind e tridhjet e tre ) lekë pa TVSH.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e parashikuar të procedurës, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

- vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, bazuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në *nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e përcaktuar ne udhezimin e Ministrisë te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021 , 2022 dhe 2023, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, të ndryshuar, mbi bazën e të cilave, AK mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimimi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore : Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin **2024**.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023, sipas të dhënave të QKB-së.*

**Argumentimi :** Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

**Shënim :** Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023.

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme bazuar nenit 39, pika 5 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.202, i ndryshuar dhe për këtë duhet të paraqesin

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht në vlerën **6,421,416**

(Gjashte milion e katerqind e njezet e nje mije e katerqind e gjashtembedhjet ) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerësimit të kontratës që prokurohet, konkretisht: **25,685,666** (Njezet e pese milion e gjashteqind e tetedhjet e pese mije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte) lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

***Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.*** Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

***Pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- i. Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Certifikatën e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar.

**Shënim :** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- ii. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore;
  - Akt kolaudimi objekti.
  - Certifikatën e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

### **2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës**

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

- **N.S - 12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

*Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41, pika 4/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” sipas lidhjes 3/1.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i

kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente duke u bazuar ne kerkesat specifike te percaktuara ne termat e references.

Bazuar në objektivat e projektit dhe komponentët kryesorë të tij janë përcaktuar kategoritë e mësipërme të licensës së projektimit të Operatorit Ekonomik të cilat janë të domosdoshme për hartimin e projektit dhe përputhen me natyrën e shërbimit dhe sipas deryres se projektimit.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerrat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

<b>Kategoria e kërkuar</b>	<b>Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</b>	<b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>	<b>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</b>	<b>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>
Kategoria N.S - 12	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit	Në preventiv zëri nga nr 1 deri nr 19	Niveli A	1787833 lekë pa tvsh
Kategoria N.S - 14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	Në preventiv zëri nga nr 21 deri nr 45	Niveli A	11055000 lekë pa tvsh

### 2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :

a) Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të deklarojnë drejtuesit teknik për këto vepra, të punësuar për periudhën e kërkuar **Qershor 2024 - Gusht 2024**, të cilët duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt sipas grafikut të punimeve, si më poshtë:

- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.  
Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.  
Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Bazuar në **UKM nr.2 date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve të ndërtimit”**, pika 1.2 Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu bazuar në po këto udhëzime Pika 4.1 Drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier. Gjithashtu bazuar në **UKM nr.3 date 15.02.2001 “Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”**

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të punësuar për periudhën e kërkuar **Qershor 2024 - Gusht 2024** si më poshtë :

- Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose

- të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit 1 (një)
- Elektracistë 2 (dy)
- Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse 2 (dy)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/di plomës	Nr NIPT ( Në rast se lëshuesi është institucion privat )	Numri i regjistrimit të certifikates së Akreditimit ( Në rast se lëshuesi është institucion privat )
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional /certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventivin (Punime mekanike/sisitem kondicionimi), sipas parashikimeve në projektin mekanik.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventivin (Punime Elektrike), sipas parashikimeve në projektin elektrik.



- **Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit** është i nevojshëm për montimin dhe operimin e pajisjeve IT apo komponentëve të tyre, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit
- **Elektriçisti 2 (dy)** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit
- **Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse 2 (dy)** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit

c) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e

d) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) ekspert zjarrfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën individuale të punës;
- certifikatë/dëshmi kualifikimi.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar referuar natyrës që parashikon projekti me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kjo kërkesë është vendosur referuar kërkesave të parashikuara në projektin MKZ, bashkëlidhur DT-ve.

e) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojnë fuqi punëtore prej minimalisht **20 (njëzet) punonjës** (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues). Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërsa ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qershor 2024 - Gusht 2024**
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor 2024 - Gusht 2024**

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga Instituti i Ndërtimit. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit.

**2.3.4** Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Nr .	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinç	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçine me kapacitet mbajtes 3.5 deri 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

1. Kamion me vinç prezencë e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe është i për transportin e paisjeve të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse .
2. Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton deri 5 ton prezencë e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe zerave Transport i materjaleve elektrike sitem ngrohje ftohje etjer .

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ekuivalente) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (ekuivalent) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

**Argumentimi :** Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit.

Për vet natyrën e veçantë, rëndësinë, vendndodhjen dhe përmasat e objekteve të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe

i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

**ISO 9001:** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001: me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001: me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001:** është standard ndërkombëtar, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001- me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.6 Deklaratë e ofruesit për modelin , kompanin prodhuese , vendin e prodhimit për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emertimi i pajisjes dhe specifikimet	Modeli	Prodhuesi	Vendi i prodhimit
1	KAMER HD 360'LED 12VDC OSD IP65			
2	F.V Central i alarmit te zjarrit, me 1 loop, tip inteligjent, i adresueshem, me regjistrim ngjarjesh, modul komunikimi, grafik karte, me porte kompjuterike, i programueshem, me bateri me 72 ore pavaresi			
3	F.V Sirene alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te brendshem,me intesitet 98dB.			

4	F.V Pulsant manual alarmi zjarri i adresueshem me thyerje xhami, tip 1469, IP-65			
5	F.V Detektore tymi multi sensitiv, inteligjent te adresueshem, me modul komunikimi			
6	Transformator rryme 200/5A			
7	Ndricues panel LED 40W 6400K 60X60			
8	Ndricues tip spot me llampa fluoeshente,2x18w			
9	Ndricues tavanor fluoeshente 1x18w			
10	Rak lokal 12U, i montuar ne mur me panel 24 portash			
11	Switch 24 porta+1 fiber optike			
12	F.V. Kaset + hidrant zjarri i brendshem. Kase brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyre te kuqer RAL 3000 - UNI 9227,me baze rezine. Dimensionet ( 370x610x190)mm, tub fleksibel 30 m, Aksesoret: saraqineske nderprerese 1½", lançe + zorre uji DN 45. Pjesa e perparme e mbyllur me çeles.			
13	F.V. Fikse zjarr me pluhur, destinacioni per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertes. Tip bombel (e levizshem). Klasa e zjarrit 55A-233BC, kapaciteti normal 12 kg, pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartesia 640 mm.			
14	F.V. Pompa e furnizimit me uje te hidranteve, Karakteristikat Teknike: - Prurja: 22 m <sup>3</sup> / h - Prevalenca: 50 mkH <sub>2</sub> O - Lidhjet: Ø 2" / PN 10 - Fuqia elektrike 5.5kW -3-400v/50Hz			
15	Paisje e jashtme VRF. 3F~415V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 85 kW / 95 kW.			
16	Paisje e jashtme VRF. 3F~415V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 78.5 kW / 87.5 kW.			

17	Paisje e brendshme kasete, 1F~230V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 14 kW / 15 kW.			
18	Paisje e brendshme kasete, 1F~230V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 11.2 kW / 12.5 kW.			
19	Paisje e brendshme kasete, 1F~230V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 10 kW / 11 kW.			
20	Paisje e brendshme kasete, 1F~230V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 9 kW / 10 kW.			
21	Paisje e brendshme kasete, 1F~230V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 7.1 kW / 8 kW.			
22	Paisje e brendshme kasete, 1F~230V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 2.8 kW / 3.2 kW.			
23	Paisje e brendshme murale, 1F~230V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 3.6 kW / 4 kW.			
24	Paisje e brendshme murale, 1F~230V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 2.8 kW / 3.2 kW.			
25	Paisje e brendshme murale, 1F~230V,50Hz. Kapaciteti Termik ne Ftohje/Ngrohje 2.2 kW / 2.4 kW.			
26	Panel dekorativ per paisjet kasete, dim 60x60.			
27	Panel dekorativ per paisjet kasete, dim 95x95.			
28	Pult komandimi individual wired per paisjet e brendshme			
29	Rekuperator nxehtesie ajer-ajer. Volumi i ajrit ne dergim / kthim 3000 m <sup>3</sup> /h / 150 Pa.			
30	Rekuperator nxehtesie ajer-ajer. Volumi i ajrit ne dergim / kthim 1800 m <sup>3</sup> /h / 150 Pa.			
31	Rekuperator nxehtesie ajer-ajer. Volumi i ajrit ne dergim / kthim 1500 m <sup>3</sup> /h / 150 Pa.			

2.3.7 Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit. Per materialet e kerkuara Operatori ekonomik duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimiti CE/certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojte qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimiti CE/ certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallarave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me çertifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi,skeda teknike,certifikata cilesie ,certifikata

konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kërkesës me sipër garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të perditesuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit

### **Shenim për operatorët ekonomik:**

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazës së nënshkrimit të kontratës do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

**Argumentimi i specifikimeve teknike është** Bazuar në dokumentacionin e projektit objekt prokurimi, ku ndër të tjerash janë dërguar dhe *Specifikimet Teknike* për punimet që do të kryhen, të cilat janë hartuar nga një shoqëri e licencuar në projektim, duke qënë se këto specifikime teknike plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik”, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për



*miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (të ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.*

**Njësia e Prokurimit**

Rudina BRAKA

Pranvera MEHMETI

Klodiana SHEHU

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
ZYRTARI I AUTORIZUAR**

Marjola MUHAJ